

Titulli i lëndës: Receptimi i letërsisë gjermane (shek 18-19) te shqiptarët

Informatat themelore për lëndën	
Njësia akademike:	Fakulteti i Filologjisë, Departamenti: Gjuhë dhe Letërsi Gjermane
Titulli i lëndës:	Receptimi i letërsisë gjermane (shek 18-19) te shqiptarët
Niveli:	BA
Statusi i lëndës:	Zgjedhore
Viti i studimeve:	Viti i IV-të
Numri i orëve në javë:	2+0
Kreditë ECTS:	3 ECTS
Koha / Vendi:	Sipas orarit
Mësimdhënësi:	Prof. asoc Dr. Albulena Blakaj- Gashi
Të dhënat kontaktuese:	Tel: 038222970/ albulena.blakaj@uni-pr.edu
Përshkrimi i lëndës:	<p>Kjo lëndë ka për qëllim të njoftojë studentët me receptimin e letërsisë gjermane të shekujve 18-19 në gjuhën shqipe, apo te shqiptarët. Letërsia gjermane është mjaft e njohur tek shqiptarët dhe ka shumë vepra të Klasikës e Romantizmit gjerman që u përkthyen, shfaqën në skenë e madje patën ndikim te autorët shqiptarë. Janë veprat e njohura të Shillerit e Gëtes të cilat janë të përkthyer e të njohura në tërë botën ato të cilat u përkthyen mjaft herët edhe tek ne, madje ata konsiderohen të jenë ndër autorët e parë të huaj që depërtuan edhe te shqiptarët. Studentët njihen me poezitë e shumta, me veprat si “Fausti”, “Vuajtjet e Verterit të ri”, “Wilhelm Tell”, “Cubat”, përrallat e vëllezërve Grim e shumë të tjera të përkthyer në shqip, analizojnë e krahasojnë verzionet e ndryshme të përkthimeve të tyre, që në gjuhën shqipe nuk janë të pakta.</p>

Qëllimet e lëndës:

- Lënda Receptimi i letërsisë gjermane te shqiptarët (shek. 18-19) ka për objektiv t'i njohë studentët me autorët kryesorë të letërsisë gjermane të shek 18- 19, veprat e tyre, vendin e tyre në letërsinë botërore dhe receptimin e veprës së tyre te shqiptarët;
- Njohja e studentëve me ndikimet, përfaqësitë, ngjajshmëritë, receptimin e përgjithësisht jetën e veprave të letërsisë gjermane në vendet shqipfolëse;
- Studentët mësojnë për ndikimin e shkrimtarëve gjerman e veprave të tyre te shkrimtarët shqiptarë
- Kjo lëndë ka për qëllim t'i mësojë studentët të analizojnë dhe të gjejnë elemente të përbashkëta te veprat letrare të të dy letërsive

Rezultatet e pritshme të nxënies:

Pas përfundimit të sukseshem te këtij kursi (lënde) studenti do të:

- dijë për autorët kryesorë të letërsisë gjermane të shek 18- 19, veprat e tyre, vendin e tyre në letërsinë botërore dhe receptimin e veprës së tyre te shqiptarët;

- të dijë të dallojë ndikimet, përfaqësitë, ngjajshmëritë, receptimin e përgjithësisht e jetën e veprave të letërsisë gjermane në vendet shqipfolëse

- dijë për ndikimin e shkrimtarëve gjerman e veprave të tyre te shkrimtarët shqiptarë dhe për rëndësinë e këtyre veprave për letërsinë shqipe;

- jetë në gjendje të shkruaj një seminar të detajuar për ndikimin e ndonjëres vepër të letërsisë gjermane te një vepër e caktuar e letërsisë shqipe

- të jetë në gjendje të gjejë elemente të përbashkëta të veprave letrare të të dy letërsive dhe të zhvillojë debat me kolegët e tij rreth kësaj

Ngarkesa e studentit (duhet të jetë në përputhje me rezultatet e nxënies së studentit)

Aktiviteti	Orë mësimore	Ditë/Javë	Gjithsej
Ligjëratat	2	15	22.5
Teori/Punë në laborator/Ushtime			
Punë praktike			
Përgatitje për test intermediar			
Konsultime me mësimdhënësin	15min	4	1
Puna në terren			
Testi, punimi i seminarit	5	1	5
Detyrë shtëpie	1	15	15
Mësimi individual (në bibliotekë apo në shtëpi)	2	10	20
Përgatitja për provimin final	20	1	20
Koha e vlerësimit (testi, kuizi, provimi final)	2	1	2
Projektet, prezantimet, etj.			
Total			85.5:25= 3.4 3 ECTS

Metodat e mësimdhënies:

Përveq ligjeratave, orët do të koncentrohen kryesisht në prezantimet e diskutimet e studentëve të cilët do të punojnë edhe nga një seminar, me temë receptimin e ndonjëres nga veprat e letërsisë gjermane të shqiptarët. Temë kjo, të cilën e zgjedhin vet nga lista e dhënë. Gjatë orëve prezantohen edhe punimet e bëra dhe për to diskutohet në klasë. Diskutimi përfshin ndikimet, përfaqësimin, ngjajshmëritë, receptimin, përkthimet dhe jetën e veprave të letërsisë gjermane të shek. 18-19 në vendet shqiptare.

Metodat e vlerësimit:	Kufiri i kalueshmërisë së lëndës është 50%. Vijueshmëria e studentit 10%; Detyrat individuale të kryera në shtëpi 20%; Provimi final 70%.
Literatura primare:	1. Ligjëratat të përgatitura nga prof. ass. dr. Albulena Blakaj-Gashi 2. Veprat kryesore të <i>Johan W. Goethes, Friedrich Schiller-it</i> e ndonje autori tjetër të shquar gjerman të këtyre shekujve dhe përkthimet e tyre në shqip 3. Blakaj, Albulena: Goethe dhe receptimi i tij te shqiptaret, OM, Prishtine, 2017
Literatura shtesë:	1. Grabovszki, Ernst: Vergleichende Literaturwissenschaft für Einsteiger, UTB, Stuttgart; 2011 2. Leskovec, Andrea: Einführung in die interkulturelle Literaturwissenschaft, Wissenschaftliche Buchgesellschaft, 2011 3. Wierlacher A.: Kulturthema Fremdheit. Leitbegriffe und Problemfelder kulturwissenschaftlicher Fremdeitsforschung. Iudicum, München, 1993. 4. Jordan, L./Kortländer, B. (Hgg.) 1995: Nationale Grenzen und internationaler Austausch. Studien zum Kultur- und Wissenschaftstransfer in Europa. Narr, Tübingen.

Politikat akademike dhe kodi i sjelljes

Studentët janë të obliguar t'i vijojnë ligjëratat dhe ushtrimet. Nuk tolerohen më shumë se tri mungesa gjatë semestrit. Detyrat që dalin nga këto orë mësimi janë të obligueshme dhe pjesë e vlerësimit të përgjithshëm të studentit. Plagjiatura dhe kopjimi në provime dhe punimet e tjera me shkrim janë të dënueshme. Në rastet e tilla studenti i nënshtrohet masave disiplinore, siç parashihet me rregulloret e UP-së.